Uji i detit është pastrues dhe e ngordhura e tij është e lejueshme

Ebu Hurerja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se një njeri e pyeti të Dërguarin e Allahut ﷺ, duke thënë: "O i Dërguar i Allahut, ne udhëtojmë me anije dhe marrim pak ujë me vete. Nëse marrim abdest me të, do të kemi etje. Atëherë, a mund të marrim abdest me ujin e detit?" I Dërguari i Allahut ﷺ u tha: "Uji i detit është pastrues dhe e ngordhura e tij është e lejueshme."

[Sahih] [رواه أبو داود والترمذي والنسائي وابن ماجه وأحمد]

Një njeri e pyeti Profetin ﷺ, duke thënë: Ne udhëtojmë me anije në det për peshkim, tregti dhe aktivitete të ngjashme, dhe marrim pak ujë të pijshëm me vete. Nëse e përdorim ujin e pijshëm për abdest dhe gusël, ai do të harxhohet dhe nuk do të kemi më ujë për të pirë. A na lejohet të marrim abdest me ujin e detit? Kësisoj, Profeti ﷺ i tha për ujin e detit: "Uji i tij është i pastër dhe pastrues; lejohet të merret abdest dhe gusël me të. Gjithashtu, është e lejuar të hahet çdo gjë që del prej tij, si peshqit, balenat dhe të tjera, edhe nëse gjendet e ngordhur dhe ka dalë në sipërfaqe pa u peshkuar.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/8355